

Pasuria e (pa)ndarë

Posedimi i pasurisë nga zyrtaret politike
dhe bashkëshortet e zyrtarëve politik

Dhjetor, 2020



Pasuria e (pa)ndarë

Posedimi i pasurisë nga zyrtaret politike
dhe bashkëshortet e zyrtarëve politik

Dhjetor, 2020

Titulli: Pasuria e (pa)ndarë: Posedimi i pasurisë nga zyrtaret politike dhe bashkëshortet e zyrtarëve politik

Autore: Alba Jakupi

Kontribuan: Dea Feti, Raesa Nikshiqi, Shahe Selmani

Viti i botimit: Dhjetor 2020

Dizajni: Envinion

Publikuar nga: Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35

Prishtina 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org +386 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2020. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

***Qëndrimet e shprehura në këtë punim jo domosdoshmërisht paraqesin ato të Konrad-Adenauer-Stiftung.**

Përmbajtja

SHKURTESA	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
QËLLIMI DHE METODOLOGJIA	8
Korniza Ligjore	8
LEGJISLACIONET E VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR	12
Të drejtat e pjeshme pronësore për gratë	13
Raportet globale të hendeqeve gjinore	13
Ndarja e pasurisë	14
Legjislatura e VII-të	16
Qeveria Hoti	24
Qeveria Kurti	32
Qeveria Haradinaj	34
Legjislatura e VI-të	36
KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS	38
GRATË ZYRTARE PA PASURI	42
PËRFUNDIM & REKOMANDIME	43
REFERENCAT	44

Shkurtesa

ABGJ Agjencia për Barazi Gjinore

LBGJ Ligji për Barazi Gjinore

AKK Agjencia Kundër Korrupsion

Përmbledhje ekzekutive

Deklarimet e pasurive të zyrtarëve publik konsiderohen të jenë një mjet i fuqishëm drejt parandalimit të korrupsionit, duke zbuluar kështu pasurimin e paligjshëm dhe konfliktin e interesit. Disponueshmëria e deklaratave të pasurisë për vëzhgimin publik, shumëfishon vlerën e anti-korrupsionit dhe abuzimit të pushtetit, duke lehtësuar punën e shoqërisë civile dhe gazetarëve në zbulimin e parregullsive dhe nxitjen e verifikimit zyrtar të këtyre deklarimeve nga Agjencia kundër Korrupsionit.

Me ligjin për deklarim, kërkohet nga zyrtarët përveç të bëjnë deklarin e tyre me pranim të detyrës, po ashtu obligohen që të bëjnë publike edhe pasurinë e bashkëshortit/bashkëshortes. Shumë nga ta, në deklaratat e tyre nuk gëzojnë pasuri të tillë në emër të bashkëshortes. Janë po të njëjtit zyrtarë publik të cilët thirren në barazi gjinore dhe fuqizim të gruas, mirëpo sa prej tyre kanë të njëjtin qëndrim me bashkëshortet e tyre? Të qenurit e pavarur financiarisht mbetet një ndër hapat më të rëndësishëm të barazisë mes gjinive dhe fuqizimit të grave.

Gëzimi i barabartë i të drejtave në Kosovë midis burrave dhe grave vazhdon të mbetet një sfidë. Edhe pse kuadri ligjor është mjaft i avancuar në promovimin e të drejtave të grave në pronë, shpërndarja e pabarabartë gjinore e burimeve ekonomike dhe financiare, i pozicionon gratë në disavantazh krahasuar me burrat në aftësinë e tyre për të marrë pjesë, për të kontribuar dhe për të përfituar nga proceset e zhvillimit të mëtutjeshëm.

Në kërkim të të drejtave pronësore, gratë zakonisht përballen me vështirësi e disavantazhe, duke theksuar kështu privimin nga posedimi i pronës. Ballafaqimet e tilla mund t'i gjurmojmë në tradita e zakone të një shoqërie patriarkale, por edhe mungesë të aktivizimit në sistemet e drejtësisë. "Gjithkush ka të drejtë të ketë pronë vetëm, si dhe në bashkëpunim me të tjerët. Askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga prona e tij." Kështu deklaroi neni 17 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Nje-

riut 1948. Sidoqoftë, e drejta e pronës është e padiskutueshme në letër, mirëpo të njëjtën nuk mund ta themi edhe për në praktikë.

Nga të gjeturat e këtij hulumtimi, rezultojnë se:

- Në **Qeverinë Hoti**, 36% e ministrave kanë pasuri në emër të bashkëshortes kundrejt 64%; ndërsa 18.5% e zëvendësministrave kanë pasuri në emër të bashkëshortes kundrejt 81.5%;
- Në **Qeverinë Kurti**, 85% e ish ministrave kanë pasuri në emër të bashkëshortes; 50% e zëvendësministrave kanë pasuri në emër të bashkëshortes.
- Në **Qeverinë Haradinaj**, 25% e ish ministrave kanë pasuri në emër të bashkëshortes; ndërsa 50% e ish zëvendësministrave të cilëve i'u është gjetur formulari i deklarinimit, kanë pasuri në emër të bashkëshortes.
- Në **Legjislaturën e VI-të**, 32% e ish deputetëve të cilët nuk u rizgjodhën në Legjislaturën e VII-të kanë deklaruar pasuri në emër të bashkëshortes.
- Në **Legjislaturën e VII-të**, 35% e deputetëve burra kanë deklaruar pasuri në emër të bashkëshortes.
- 55% e **Kryetarëve të Komunave** kanë deklaruar pasuri në emër të bashkëshorteve të tyre.

QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij hulumtimi është krijimi i një pasqyre të përgjithshme në lidhje me nivelin e posedimit të pasurisë të grave zyrtare publike, si dhe të grave të zyrtarëve publik në deklaratën e pasurisë në emër të të dy bashkëshortëve. Në këtë hulumtim përfshihet pasuria e grave zyrtare publike të cilat kanë pronë në emrin e tyre; pasuria totale e burrave (zyrtarë publik) krahasuar me atë të regjistruar në emrin e bashkëshortëve; nisjen e sektorit të ndjeshëm gjinor në Platformën e Deklarimit¹, si dhe ofrimin e rekomandimeve eventuale që mund të çojnë në avancimin e të drejtave dhe pozitës së grave në pronë.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë bazuar në portalin e Lëvizjes FOL deklarimi.org², i cili ofron mundësinë e krahasimit të pasurisë të zyrtarëve publik, të dhëna këto të marra nga formularët e deklaratimit tek Agjencia kundër Korrupsion për vitin 2020. Kjo platformë për krahasimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik përfshin rreth 500 zyrtarë, ku për secilin në mënyrë individuale qytetarët e Kosovës mund t'i krahasojnë rritjen apo uljen e pasurisë së tyre ndër vite. Prandaj, për qëllim të analizimit të pasurisë së secilit zyrtar/e që ka deklaruar pasurinë dhe më qëllim që të kemi sa më shumë të dhëna konkrete, ne kemi analizuar dhe mbledhur të gjitha të dhënat e pasurisë të cilën zyrtarët publik e kanë në emër të bashkëshorteve të tyre e gjithashtu edhe vet gratë deputete/ministre e zyrtare të tjera publike, se sa pasuri kanë në emrin e tyre.

Ky hulumtim siguron të dhëna rreth pasurisë së këtyre zyrtarëve të dy (2) legjislativave, tre (3) qeverive dhe kryetarët e komunave me fokus në ndarjen e pasurisë me bashkëshortet e tyre. Në këtë hulumtim janë përfshirë; Kryeministri/at, zëvendës kryeministrat, ministrat dhe zëvendës ministrat, deputetët, dy ish Kryeministra, ish zëvendës kryeministrat, ish ministrat dhe ish deputetët, si dhe Kryetarët

e Komunave të Republikës së Kosovës, **formularët e të cilëve figurojnë në AKK**. Përmes të dhënave, Lëvizja FOL ka analizuar pasurinë totale të zyrtareve gra, si dhe pasurinë totale të zyrtarëve burra dhe përqindjen e kësaj pasurie që këta të fundit e kanë deklaruar në pronësi të bashkëshorteve.

Deklarimi i pasurisë për vitin 2020, zakonisht përfshinë zyrtarët të cilët ishin në pushtet në vitin 2019, e të cilët kanë pasur për obligim ta deklarojnë pasurinë deri në fund të muajit mars. Mirëpo ndryshimet politike në vend kanë bërë që përveç deklaratimit të pasurisë së kabinetit të Qeverisë së Haradinajt, dhe legjislaturës së VI, aty gjithashtu të deklarohen pasurinë edhe Legjislatura e VII e Kuvendit të Kosovës, kabineti i Qeverisë Kurti, të cilët kanë deklaruar pasurinë me rastin e marrjes dhe largimit nga pushteti dhe gjithashtu kabineti i Qeverisë Hoti të cilët kanë deklaruar pasurinë me rastin e marrjes së mandatit.

Korniza Ligjore

Të drejtat e barabarta të grave janë të garantuara me të gjitha aktet juridike, si dhe me instrumentet apo mekanizmat vendor dhe ndërkombëtar. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik, garanton barazinë e plotë në të gjitha aspektet jetësore. Në nenin 7 të Kushtetutës, përkatësisht në paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se:

*"Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore."*³

1 Ndjeshmëria gjinore ka për qëllim modifikimin e sjelljes duke rritur ndërgjegjësimin ndaj shqetësimeve të barazisë gjinore.

2 Platforma e deklaratimit të pasurisë <http://deklarimi.org/>

3 KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS – Neni 7 paragrafi 2. <http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

Republika e Kosovës ka në fuqi edhe një varg ligjesh të cilat e rregullojnë barazinë gjinore dhe të drejtat pronësore, të cilat janë:

1. Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore (LBGJ);
2. Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës;
3. Ligji Nr. 2004/26 për Trashëgiminë e Kosovës;
4. Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore;
5. Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ligji Nr. 2004/32 për Familjen⁴: Ky ligj rregullon qartazi çështjet familjare si dhe të drejtat dhe detyrimet të cilat dalin nga martesë. Parimet e përgjithshme familjare vetëm se janë të parapara nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përkatësisht tek neni 37 paragrafi 2 *"E drejta në martesë dhe familje"* ku martesë dhe zgjidhja e saj rregullohet me ligj me parime të barazisë së bashkëshortëve, ndërsa Ligji për familje rregullon këto çështje në mënyrë më të detajuar.

Neni 3 i këtij ligji parasheh barazinë absolute mes burrit dhe gruas, kurse neni 47 qartëson pasurinë e përbashkët dhe atë se çfarë përfshihet në pasurinë e përbashkët martesore:

"Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë"

Neni 50.2 i këtij ligji parasheh se nëse pasuria është regjistruar vetëm në emrin e njërit nga bashkëshortët si bartës të pasurisë në regjistrin e të drejtave në pasuri të patundshme, konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të të dy bashkëshortëve, pasi që pasuria nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve.

4 LIGJI PER FAMILJEN – NENI 3 / NENI 47 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>

Ligji Nr. 2004 / 26 për Trashëgimi⁵: Të drejtat e barabarta të grave dhe burrave për të trashëguar njihen përmes këtij ligji, duke rregulluar kështu çështjet pronësore në trashëgimi dhe të drejtën për të qenë trashëgimtar pa kurrfarë dallimi apo diskriminimi. Neni 3 i këtij ligji cek se:

"3.1. Të gjithë personat fizik në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi."

Përmes Ligjit për trashëgimi, bëhet e ditur barazia e plotë trashëguese pa dallim gjinie, në rast se fëmija është martesor apo jashtëmartesor, biologjik apo i adoptuar.

Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore⁶: Ky ligj rregullon pronësinë si dhe të drejtat sendore të kufizuara si posedimin, të drejtat sendore të sigurimit si dhe të drejtat sendore të shfrytëzimit. Këto të drejta sendore të kufizuara mund të krijohen në pronësi apo në të drejta sendore të tjera që mund të jenë të përshtatshme për këtë qëllim.

Paragrafi 1 i nenit 29 të këtij ligji, ku flitet për "bashkimin" cek se:

1. Nëse sendet e luajtshme të pronarëve të ndryshëm bashkohen ashtu ndërmjet veti që bëhen përbërës qenësor të një sendi të vetëm, atëherë pronarët e deritanishëm bëhen bashkëpronarë të sendit të ri. Pjesëmarrjet përcaktohen sipas proporcioneve të vlerave, të cilat i kanë pasur sendet në momentin e bashkimit.

Ndërsa pikat 1 dhe 2 të nenit 77 të ligjit në fjalë, ku flitet për "Pronësinë e përbashkët" thuhet se:

1. Nëse disa persona kanë të drejtë pronësie mbi një send në atë mënyrë që pjesët e tyre nuk janë të caktuara, atëherë ata janë pronarë të përbashkët.

2. Pronësia e përbashkët mund të krijohet përmes ligjit ose përmes kontratës.

5 Ligji për trashëgimi I Republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2407>

6 Ligji për pronësi dhe të drejta sendore <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2643>



Ky hulumtim siguron të dhëna rreth pasurisë së këtyre zyrtarëve të dy (2) legjislativave, tre (3) qeverive dhe kryetarët e komunave me fokus në ndarjen e pasurisë me bashkëshortet e tyre. Në këtë hulumtim janë përfshirë; Kryeministri/at, zëvendës kryeministrat, ministrat dhe zëvendës ministrat, deputetët, dy ish Kryeministra, ish zëvendës kryeministrat, ish ministrat dhe ish deputetët, si dhe Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës, formularët e të cilëve figurojnë në AKK.

Përveç kësaj, Republika e Kosovës ka në zbatim edhe Ligjin Nr. 04/L-0507⁷ për deklarimin e pasurisë, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë. Neni 5 i këtij ligji flet mbi “deklarimin e pasurisë”, përkatesisht pika 2 ku ceket se:

2. Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas për çdo anëtarë i familjes me pasuri të regjistruar në emër të tij dhe i bashkëngjitet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarimin.

Ky ligj, përcakton detyrimet e zyrtarëve të lartë publik për të deklaruar pasuritë, dhuratat dhe origjinën e tyre. Për fat të mirë, Ligji për Deklaratën është mjaft specifik dhe ka përkufizime të qarta të përbashkjes së detyrimeve të deklarimit për materialet e përfituara të vetë zyrtarëve publikë, anëtarëve të familjes dhe personave të lidhur. Në formën e kërkuar të deklarimit, është vendosur një pjesë e veçantë nëse pasuria e deklaruar është në pronësi të personit zyrtar publik, bashkëshortit të tij apo është një pasuri e përbashkët.

Ndërkaq, duke pasur parasysh se ligjet e lartë përmendura nuk janë plotësisht korrekte sa i përket përfaqësimit adekuat të interesave të të gjitha gjinive, udhëzime administrative kanë zënë vend në mënyrë që të arrihet përfshirja adekuate. Masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve, pësuat ndryshim dhe plotësim të fundmi, me qëllim të stimulimit të regjistrimit të pronave të paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve. Udhëzimi administrativ (QRK) 02/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (QRK) 03/2016⁸ për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve, cek se:

Neni 1

“Qëllimi i këtij udhëzimi është të stimuloj regjistrimin e pronave të paluajtshme të përbashkëta në emër të të dy bashkëshortëve në regjistrat publik”

Neni 5, pika 4

“Në rastet kur vetëm njëri prej bashkëshortëve regjistrohet si bartës i së drejtës pronësore, apo të posedimit për pasurinë e përbashkët në regjistrin e të drejtave të pasurisë së paluajtshme, do të konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të dy bashkëshortëve”

⁷ Ligji për Deklarim të Pasurisë <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767>

⁸ Udhëzimi administrativ (QRK) 02/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (QRK) 03/2016 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17698>

Ndër të tjera, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar edhe Udhëzimin Administrativ Nr.08/2018⁹ për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve. Përmes këtij udhëzimi, synohet simulimi i regjistrimit të pasurisë në emër të dy bashkëshortëve, me qëllim të fuqizimit të gruas në shoqëri.

Përveç Kushtetutës dhe ligjeve që promovojnë barazinë gjinore, Republika e Kosovës njih edhe punën e Agjencisë Për Barazi Gjinore (tutje do t'i referohemi me shkurtesën ABGJ). Kjo Agjenci është themeluar me vendim të Qeverisë së Kosovës në bazë të vendimit 5/131 të datës 01.02.2005. ABGJ është organ i veçantë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, pra kjo është agjenci ekzekutive e cila vepron në kuadër të zyrës së kryeministrit të Republikës së Kosovës. Në bazë të përgjegjësive si mekanizëm institucional për barazi gjinore ABGJ ka përgjegjësi që të mbështetë dhe promovoj për zbatimin e dispozitave të LBGJ-së, si dhe akteve nënligjore që nxirren me qëllim të promovimit të të drejtave të barabarta, si dhe implementimit të tyre në praktikë. ABGJ-ja i propozon Qeverisë ndryshimin dhe plotësimin e shumë ligjeve si dhe akteve nënligjore që konsideron se mund të kenë ndikim në arritjen e barazisë gjinore. Po ashtu, ABGJ identifikon edhe harton politika që promovojnë barazinë gjinore dhe monitorojnë zbatimin e tyre, merr pjesë në përgatitjen e ligjeve, akteve nën ligjore, strategjive, bashkëpunon me shoqërinë civile, organizon trajnime për përfshirjen e integritetit ligjor dhe buxhetimit gjinor në institucione e të tjera.

Të drejtat e barabarta të grave janë të garantuara edhe me instrumentet/mekanizmat ndërkombëtarë si në vijim:

1. Deklarata Universale Për Të Drejtat e Njeriut;
2. Konventa Ndërkombëtare për të drejtat Ekonomike, Sociale dhe të drejtat Kulturore;
3. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike;
4. Konventa Për Eliminimin e të gjithave Formave të Diskriminimit ndaj Gruas.

9 Udhëzimi Administrativ për masat e veçanta <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17698>

LEGJISLACIONET E VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Ballkani Perëndimor mbetet përherë një rajon i përkeqësuar në aspektin e kushteve socio-ekonomike dhe paqëndrueshmërisë politike, të cilat kryesisht ndikojnë në grupet e cenueshme, veçanërisht gratë, pasi që pozicioni i marginalizuar i tyre kryqëzohet me aspekte të tjera të diskriminimit të tyre. Megjithëse korniza ligjore është solide për mbrojtën e grave dhe trajtimin e tyre të barabartë në të gjitha fushat e jetesës, ekziston një mospërputhje e madhe midis ligjeve dhe zbatimit të tyre në praktikë, kështu që problemet e shumta në lidhje me zbatimin efektiv të mekanizmave të barazisë gjinore ende vazhdojnë të jenë më se të pranishme në të gjitha shoqëritë e Ballkanit Perëndimor, dhe jo vetëm në Kosovë.

Pozicioni i grave në shoqëri bazohet në pavarësinë e tyre ekonomike, tregues të së cilit janë faktorët e popullsisë aktive si puna, pronësia dhe e drejta e trashëgimisë. Si në Kosovë, ashtu edhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, gratë kanë qenë gjithherë të angazhuara në punë të papaguara.

Shumica e këtyre vendeve kanë miratuar ligje duke marrë parasysh raste më specifike të pabarazive midis burrave dhe grave, veçanërisht ligjet që krijojnë baza të forta për një pavarësi të plotë ekonomike të grave. Në Shqipëri është Kodi i Punës (2015), ose Kodi i Familjes (2003) i cili duhet të sigurojë mbrojtje për të drejtat e grave në pronësi¹⁰. Në Malin e Zi këto të drejta mbrohen nga Ligji i Punës¹¹ i cili *“ndalon diskriminimin direkt dhe indirekt ndaj punëkërkuessve dhe punonjësve për shkak të seksit, gjuhës, racës, fesë, ngjyrës së lëkurës, ... apo ndonjë tipar tjetër personal”* (Neni 5)¹² Serbia, në anën tjetër ka miratuar Ligjin e Punës.¹³

Në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, burrat i përkasin pjesës aktive të popullsisë më shumë sesa gratë dhe përqindjet e grave të punësuarra - dhe për këtë arsye, numri i grave që paguhen aktualisht për punën e tyre - është më i vogël se ai i burrave. Sipas sondazheve të secilit vend shohim se nga numri total i të papunëve përqindja e grave është si vijon:

- Në Kosovë, 83.4% e grave **nuk janë** të punësuarra;
- Në Shqipëri 50.3% e grave **janë** të punësuarra;
- Në Maqedoninë e Veriut, 39.1% të grave **janë** të punësuarra;
- Në Malin e Zi, 44.4% e grave **janë** të punësuarra.

Një tjetër parametër për të drejtat ekonomike dhe sociale për gratë janë çështjet e pronësisë dhe trashëgimisë. Këto çështje të rregulluara para së gjithash përmes masave legjislative nuk mund të zbatohen pa u ballafaquar me zakonet tradicionale patriarkale të cilat gjithmonë kanë privilegjuar përfituesit meshkuj.

Sa i përket pronës,

- Në Malin e Zi gratë zotërojnë vetëm 4% të shtëpive dhe 8% të tokës;
- Në Maqedoni të Veriut, pronësia e tokës është mesatarisht 16% për gratë;
- Në Bosnjë dhe Hercegovinë, 15% e të gjitha shtëpive janë në pronësi të grave;

Pavarësisht se të gjitha kornizat ligjore të këtyre vendeve mbështesin pa dyshim pavarësinë e grave, pa njohur dhe pranuar potencialin e tyre të plotë për sa i përket vlerësimit të punës së tyre, pak mund të bëhet për të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor.

10 Kodi i Punës - Gazeta Zyrtare në Shqipëri - Nr. 796

11 Ligji për Ndalimin e Diskriminimit - Gazeta Zyrtare e Malit të Zi, nr. 46/2010, 40/2011, 18/2014 dhe 42/2017

12 Ligji i Punës - Gazeta Zyrtare e Malit të Zi, Nr. 49/2008, 53/2017.

13 Ligji i Punës - Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr. 24/05, 61/05, 54/09

mor. Pa stabilitet në të drejtat e pronës, pavarësia ekonomike e grave poashtu humbet stabilitetin e saj.

Të drejtat e pjeshme pronësore për gratë

Të drejtat e grave për zotërim dhe trashëgimi pronësore janë të bazuara në instrumente thelbësore të të drejtave të njeriut, me theks të veçantë në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave. E garantuar edhe me mekanizma ndërkombëtar, gratë kanë të drejtën e gëzimit të të gjitha të drejtave të tyre, sidomos për të përdorur, trashëguar apo zotëruar pasurinë e tyre veçanërisht atë të paluajtshme.

Sipas UN Women, globalisht gratë kanë më pak pasuri të paluajtshme dhe të drejta më të pakta në posedim të saj sesa burrat. Gratë përbëjnë më pak se 20 përqind të zotëruesve të pasurisë së paluajtshme në botë, ndonëse të njëjtat përbëjnë 43 përqind të fuqisë punëtore¹⁴. Legjislacioni diskriminues në një numër shtetesh i pengon gratë, edhe në ditët e sotme, të gëzojnë të drejtat e barabarta për qasje në mundësi dhe burime ekonomike. Stereotipet e shumta të cilat shërbejnë si një paracaktim i roleve dhe përgjegjësisë për gratë dhe burrat, i vendosin gratë në statusë vartëse duke kufizuar kështu mundësitë e tyre ekonomike. Ndonëse shumë vende kanë vendosur masa anti-diskriminimi, ato nuk kanë ndihmuar në barazimin e mundësive në jetën ekonomike të grave. Ato mbesin të përqendruara në mënyrë disproporcionale në punësim; ekspozohen në vazhdimësi ndaj diskriminimit; ekziston hendeku i pagave si dhe vendi i tyre i punës nuk qëndron plotësisht i sigurtë nga pushimi i lehonisë.

Qeverisja ekonomike gjenerohet jo vetëm de jure nga vendimmarrja politike, por gjithashtu de facto

nga aktivitetet e institucioneve ekonomike dhe financiare, ndërmarrjeve dhe korporatave në nivele ndërkombëtare dhe kombëtare. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore, bankat e zhvillimit rajonal dhe Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) kufizojnë politikat ekonomike kombëtare. Meqenëse kompanitë e mëdha ushtrojnë fuqi të konsiderueshme në përcaktimin e politikave të ndryshme, si sektor privat ato krijojnë dhe përcaktojnë vendet e punës, duke prodhuar rritje dhe paracaktuar parametrat e shpërndarjes së të ardhurave, duke ndikuar kështu në kushtet sociale të komunitetit në të cilin ato veprojnë.

Ekzistojnë pengesa për qasjen e grave në pozitë udhëheqëse dhe vendimmarrëse në këto institucione ekonomike dhe financiare, të cilat gjenerojnë politika që përcaktojnë cilësinë e jetës së grave, burrave, fëmijëve dhe komuniteteve. Për më tepër, në fushën e përgjegjësisë së korporatave, dëmi gjinor ndaj grave që rezultojnë nga biznesi ndërkombëtar dhe politikat tregtare ka qenë kryesisht i padukshëm. Ekziston nevoja për të adresuar këto çështje dhe për të zhvilluar mjete për reagimin gjinor në udhëheqjen ekonomike dhe përgjegjësinë e korporatave.

Raportet globale të hendeqeve gjinore

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga USAID mbi të drejtën pronësore, 73% e qytetarëve në Kosovë nuk kanë njohuri për të drejtat e tyre pronësore. Ndërsa vetëm 3,8% e grave në Kosovë trashëgojnë pronë të paluajtshme nga prindërit e tyre, dhe vetëm 19% e tyre posedojnë pronë në emër të tyre. Në anën tjetër, Anketa e Fuqisë Punëtore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2019¹⁵, paraqet nivelin e punësimit të popullsisë së Kosovës, që është hap parësor drejt pavarësisht të grave financiarisht. Sipas rezultateve të kësaj ankete, vetëm dy të tretat e popullsisë janë në moshë pune, në kuadër të së cilës 40.5% e tyre janë në marrëdhënie pune apo konsiderohen si fuqi punëtore. Shkalla e punësimit

14 UN Women – Facts & Figures <https://www.unwomen.org/en/news/in-focus/commission-on-the-status-of-women-2012/facts-and-figures>

15 Anketa e Fuqisë Punëtore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2019 <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/anketa-e-fuqise-punetore-afp-2019>

në Kosovë për vitin 2019 ka qenë 30.1%, ku 46.2% e tyre janë burra dhe 13.9% janë gra. Sipas anketës në fjalë, shkalla e papunësisë për vitin 2019 ishte 25,7% ku papunësia theksohet më tepër tek gratë, me 34.4% sesa tek burrat me 22.6%.

Ndërsa, përgjatë 14 viteve të fundit, Forumi Ekonomik Botëror ka përpiluar një raport i cili shërben si busullë për të parë progresin në hendeqet relative mes grave dhe burrave në fusha të ndryshme, duke përfshirë edhe atë ekonomik. Përmes saj, vendet e përfshira në raport mund të gjejnë përparësitë përkatëse në kontekstet specifike të raportit. Sipas Raportit Global të Hendekut Gjinator 2019¹⁶, mesatarja e arritjes së barazisë gjinore ka arritur në 68.6%. Deri më sot, ekziston një hendek mesatar gjinor prej 31.4% që mbetet për t'u mbyllur globalisht. Rritja pozitive e mbylljes së hendekut gjinor përkthehet që 101 nga 149 vendet e mbuluara nga ky raport të kenë arritur rezultate të kënaqshme rreth arritjes së barazisë.

Ndërsa në anën tjetër, sipas një raporti mbi hendekun gjinor ekonomik dhe social në botë, SI&GI¹⁷ theksohet se vendosja e grave dhe burrave në një bazë të barabartë në çdo cep të jetës politike, ekonomike dhe shoqërore është jo vetëm një domosdoshmëri morale, por edhe ekonomike. Siç thekson ky raport, kostoja e ekonomisë globale e diskriminimit me bazë gjinore në institucionet sociale është 6 trilion dollarë (7.5% e GDP-së globale). Ndikimi social i pabarazisë gjinore ndikon në cilësinë e jetës së miliona grave në çdo sferë, por gjithashtu ka pasoja për familjet dhe komunitetet e tyre. Në këtë raport, vendet renditen sipas nivelit të tyre të diskriminimit. Kosova, në kategorinë e diskriminimit në familje ka një përqindje prej 27.8%; në kategorinë e qasjen e kufizuar në burimet produktive dhe financiare ka një përqindje prej 17.7% si dhe 15% në kategorinë e lirive të kufizuara qytetare.

Ndarja e pasurisë

Në mënyrë që të arrihet barazia e plotë, është esenciale të punohet në këtë drejtim nga të gjitha pjesët e shoqërisë, jo vetëm nga ana shtetërore përmes masave të ndërmarra apo ligjeve, por edhe në bërthamën e secilës familje dhe institucioni edukativ. Pavarësimi i gruas, kërkon punë për t'u arritur dhe si e tillë mbetet një çështje zingjirore; fillon që nga shkollimi i saj, trashëgimia prindërore, barazia bashkëshortore, vendi i sigurtë i punës e çdo sferë jetësore. Për t'u ndalur tek pavarësia ekonomike, e cila është kryesore sa i përket avancimit të gruas në shoqëri, përderisa mos pavarësia ekonomike shkakton varësi të gruas ndaj bashkëshortit apo edhe pjesëtarëve të tjerë të familjes.

Fuqizimi i grave është një ndër pikat kyçe të çdo programi politik të partive në Kosovë. Madje, kjo temë zë vend në shumë diskutime, mbledhje, e konferenca. Sa prej këtyre politikanëve mbështesin gratë e tyre në luftën për barazi gjinore prapa dyerve të mbyllura? Me deklarin e pasurisë të çdo zyrtari politik, shfaqet edhe një pasqyrë e ndarjes së pasurisë mes bashkëshortëve, duke na treguar kështu nëse qëndrimet e tyre dhe avokimi i vazhdueshëm për fuqizim të gruas dhe barazi gjinore është vetëm për poena politik.

Në tabelat më poshtë, është paraqitur pasuria e deklaruar e krerëve aktual të shtetit për vitin 2020, të ndarë në pasuri totale, pasuri në emër të bashkëshortes si dhe të hyrat vjetore të kësaj të fundit.

16 Raporti Global i Hendekut Gjinator - http://www3.weforum.org/docs/WEF_GGGR_2020.pdf

17 Indeksi Gjinator - www.genderindex.org

Presidenti i VI i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi, ka deklaruar pasurinë totale si në vijim:

Presidenti i VI - Hashim Thaçi




Tabela 1: Pasuria e deklaruar në vitin 2020 nga Presidenti i VI-të i Kosovës

Ndërsa, U.D. e Presidentit dhe Kryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, njëherësh edhe Kryetarja e parë grua, ka deklaruar pasurinë totale si në vijim:

U.D e Presidentit dhe Kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës - Vjosa Osmani Sadriu



Tabela 2: Pasuria e deklaruar në vitin 2020 nga U.D e Presidentit

Legjislatura e VII-të

Kjo legjislaturë ka 120 deputetë ku 38 prej tyre janë gra dhe 82 janë burra. Vetëm 24 gra deputete kanë deklaruar se kanë pasuri në emër të tyre ndërkaq 14

të tjera, përveç të hyrave vjetore, nuk kanë deklaruar pasuri në emër të tyre. Në tabelat më poshtë, është paraqitur pasuria e deklaruar e grave deputete për vitin 2020.

Deputetja	Pasuria në emër të saj	Deputetja	Pasuria në emër të saj	Deputetja	Pasuria në emër të saj
Albena Reshitaj	78,500.00€	Fatmire Kollqaku	58,500.00€	Arbëreshë Krasniqi	0€
Arbërije Nagavci	18,000.00€	Fidan Jilta	26,920.00 €	Arbëreshë Kryeziu-Hyseni	0€
Ariana Shoshi Musliu	Nuk ka formularë të deklarimit	Fjolla Ujkani	9,900.00€	Arta Bajralija	0€
Besa Gaxheri	53,000.00€	Teuta Haxhiu	4,000.00€	Lirije Kajtazi	0€
Blerta Deliu Kodra	20,000.00€	Ganimete Musliu	14,174.87€	Marigona Geci	0€
Donika Kadaj Bujupi	19,000.00€	Jasmina Dedic	25,000.00€	Yllza Hoti	0€
Duda Balje	105,000.00€	Labinotë Demi Murtezi	5,500.00€	Besa Ismajli Ahmeti	0€
Eliza Hoxha	54,000.00€	Vjosa Osmani Sadriu	80,700.00€	Doruntinë Maloku Kastrati	0€
Evgjeni Thaqi Dragusha	41,800.00€	Verica Ceranic	4,000.00€	Mimoza Kusari Lila	0€
Miljana Nikolic	33,000.00€	Saranda Musliu	15,000.00€	Fitore Pacolli	0€
Time Kadrijaj	51,000.00€	Valentina Bunjaku Rexhepi	10,500.00€	Floretë Zejnullahu	0€
Valdete Idrizi	49,020.00€	Zikreta Aliti	260,000.00€	Rrezarta Krasniqi	0€
Mirlinda Sopi Krasniqi	4,500.00€	Vlora Limani	0€	Saranda Bogujevci	0€

Tabela 3: Pasuria e deklaruar në vitin 2020 nga deputetët e legjislaturës së VI-të

Në tabelën në vijim janë paraqitur deputetet që kanë deklaruar pasuri në emër të grave të tyre në anën e

majtë si dhe ata të cilët nuk kanë pasuri në emër të bashkëshortes në anën e djathtë:

Deputetët	Totali i pasurisë në emër të gruas	Deputetët	Totali i pasurisë në emër të gruas	Deputetët të cilët NUK kanë pasuri në emër të gruas			
Bajrush Xhemajli	57,320.00 €	Haxhi Avdyli	33,610.00 €	Abelard Tahiri	Agon Batusha	Albert Kinolli	Arben Gashi
Bedri Hamza	56,934.33 €	Ivan Todosijevic	18,400.00 €	Adem Hodza	Alban Hyseni	Ali Berisha	Arbër Tolaj
Bekë Berisha	307,006.06 €	Kadri Veseli	211,784.00 €	Arbër Rexhaj	Ardian Shala	Artan Abrashi	Behxhet Pacolli
Bekim Haxhiu	29,529.00 €	Liburn Aliu	120,456.69 €	Branislav Nikolic	Daut Haradinaj	Elbert Krasniqi	Elmi Reçica
Dimal Basha	12,000.00 €	Mefail Bajqinovci	35,208.00 €	Eman Rrahmani	Endrit Shala	Enver Halitaj	Enver Hoxhaj
Ekrem Hyseni	60,000.00 €	Memli Krasniqi	36,188.00 €	Etem Arifi	Fatmir Limaj	Fetah Rudi	Xhavit Uka
Fatmir Xhelili	91,739.00 €	Pal Lekaj	12,300.00 €	Fidan Rekaliu	Gazmend Abrashi	Gazmend Gjyshnica	Gazmend Syla
Faton Bislimi	35,750.00 €	Rexhep Selimi	14,740.00 €	Hajredin Kuqi	Hatim Baxhaku	Haxhi Shala	Hekuran Murati
Fikrim Damka	35,000.00 €	Sejdi Hoxha	14,745.00 €	Igor Simic	Ilir Ferati	Ilir Tasholli	Ismet Beqiri
Fitim Haziri	7,100.00 €	Shpejtim Bulliqi	60,560.00 €	Jahja Kokaj	Kujtim Gashi	Kujtim Shala	Ljubinko Karagjiq
Frashër Demaj	102,774.00 €	Uran Ismaili	37,681.00 €	Mergim Lushtaku	Milos Perovic	Rasim Demiri	Rasim Selmanaj
Hajrullah Çeku	207,768.00 €	Valon Ramadani	9,500.00 €	Salih Zyba	Shkumbin Demaliaj	Shkumbin Gashi	Shkëmb Manaj
Hajredin Kuqi	22,000.00 €	Veton Berisha	5,900.00 €	Slavko Simic	Visar Hoti		
Zoran Mojsilovic	37,422.20 €						

Tabela 4: Pasuria e deklaruar e deputetëve të legjislaturës së VI-të në emër të bashkëshorteve

Pavarësisht se rreth 60 përqind e grave të deputetëve, janë të punësuara dhe kanë të deklaruar të ardhurat e tyre vjetore, kjo nuk reflekton në pasurinë në emër të tyre. Detajet për pasurinë e secilit deputet dhe atë çfarë kanë deklaruar në emër të grave e gjeni më poshtë.

1. **Abelard Tahiri** ka deklaruar pasuri prej 1,220,184.00 €, bashkëshortja e të cilit ka para të gatshme prej 1,100.00 € dhe të hyra vjetore prej 4,320.00 €, mirëpo e njëjta nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
2. **Adem Hodza** ka deklaruar pasuri prej 331,937.00 € mirëpo bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme, aksione apo para të gatshme.
3. **Agon Batusha** ka deklaruar pasuri prej 186,200.00 € mirëpo bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme, aksione apo para të gatshme.
4. **Alban Hyseni**, ka deklaruar pasuri totale prej 543,330.00 €, bashkëshortja e tij ka para të gatshme të deklaruara me vlerë prej 400 € dhe të hyra vjetore prej 4,440.00 € mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme, aksione.
5. **Albert Kinolli**, ka deklaruar pasuri prej 280,316.00 € mirëpo bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme, aksione apo para të gatshme.
6. **Ali Berisha**, ka deklaruar pasuri prej 419,580.00 € mirëpo bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme, aksione apo para të gatshme.
7. **Arben Gashi**, ka deklaruar pasuri me vlerë prej 206,476.00 €, të hyrat vjetore të bashkëshortes së tij janë 19,762.00 € mirëpo e njëjta nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme, aksione apo para të gatshme të deklaruara.
8. **Arbër Tolaj** ka deklaruar pasuri prej 485,815.21 € ndërsa bashkëshortja e tij ka para të gatshme të deklaruara prej 6,411.79 € dhe të hyra vjetore prej

11,259.00 €. E njëjta nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.

9. **Arbër Rexhaj** ka deklaruar pasuri prej 179,809.14 €. Bashkëshortja e tij ka deklaruar para të gatshme në vlerë prej 500.00 € dhe të hyra vjetore prej 5,400.00 €, mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
10. **Ardian Shala** ka pasuri prej 170,422.00 €. Bashkëshortja e tij ka deklaruar 1,992.00 € para të gatshme dhe 5,196.00 € të hyra vjetore, mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
11. **Artan Abrashi** ka deklaruar pasuri prej 117,323.82 €, bashkëshortja e të cilit ka deklaruar 150.00 € para të gatshme dhe 9,720.00 € të hyra vjetore, por e njëjta nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
12. **Bajrush Xhemajli** ka deklaruar pasuri prej 281,453.34 €. Bashkëshortja e tij ka pasuri të luajtshme prej 9,000.00 €, para të gatshme të deklaruara prej 40,640.00 € dhe të hyra vjetore prej 7,680.00 €, mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme apo aksione.
13. **Bedri Hamza** ka deklaruar pasuri prej 315,827.89 €, bashkëshortja e të cilit ka pasuri të paluajtshme prej 39,000.00 €, të luajtshme prej 11,000.00 €, para të gatshme prej 997.44 € dhe të hyra vjetore prej 5,936.89 €.
14. **Bekë Berisha** ka deklaruar pasuri prej 860,373.26 €, ndërsa bashkëshortja e tij ka pasuri të paluajtshme prej 259,000.00 € dhe të hyra vjetore prej 48,006.00 € mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të luajtshme apo aksione.
15. **Bekim Haxhiu** ka deklaruar pasuri prej 517,516.90 €. Bashkëshortja e tij ka pasuri të luajtshme në emër të saj prej 13,800.00 €, para të gatshme prej 3,902.00 € dhe të hyra vjetore prej 11,827.00 €, mirëpo jo dhe pasuri të paluajtshme apo aksione.

- 16. Branislav Nikolic** ka deklaruar pasuri prej 353,671.88 €, të hyrat vjetore të gruas së tij janë deklaruar 6, 478.87 € mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 17. Daut Haradinaj** ka deklaruar pasuri prej 543,721.17 €. Bashkëshortja e tij ka para të gatshme orej 6,656.27 € si dhe 19,696.00 € të hyra vjetore, mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 18. Dimal Basha** ka deklaruar pasuri prej 587,800.00 €, ndërsa bashkëshortja e tij ka deklaruar pasuri prej të luajtshme prej 12,000.00 €, mirëpo e njëjta nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme apo aksione si dhe nuk ka të hyra vjetore.
- 19. Ekrem Hyseni** ka deklaruar pasuri prej 120,100.00 €. Bashkëshortja e tij ka deklaruar pasuri të paluajtshme prej 55,000.00 € dhe ka 5,000.00 € të hyra vjetore. E njëjta nuk ka deklaruar pasuri të luajtshme, aksione apo para të gatshme në kohën e deklarimit.
- 20. Elbert Krasniqi** ka deklaruar pasuri prej 288,042.00 € ndërsa bashkëshortja e tij ka të hyra vjetore prej 12,036.00 € mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 21. Elmi Reçica** ka deklaruar pasuri prej 457,997.07 €, ndërsa bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme, aksione apo para të gatshme dhe nuk ka të hyra vjetore.
- 22. Eman Rrahmani**, ka deklaruar pasuri totale prej 147,221.00€ ndërsa bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme, aksione apo para të gatshme dhe nuk ka të hyra vjetore.
- 23. Endrit Shala** ka deklaruar pasuri prej 791,188.00 €, ndërsa të hyrat vjetore të bashkëshortes së tij janë 5,100.00 € mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 24. Enver Halitaj** ka deklaruar pasuri prej 1,839,020.00 € ndërsa bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme, aksione apo para të gatshme dhe nuk ka të hyra vjetore.
- 25. Enver Hoxhaj** ka deklaruar pasuri prej 468,319.00 €. Bashkëshortja e tij ka të hyra vjetore prej 14,971.00 € mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 26. Etem Arifi** ka deklaruar pasuri prej 636,875.69 €, ndërsa bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme, aksione apo para të gatshme dhe nuk ka të hyra vjetore.
- 27. Fatmir Limaj** ka deklaruar pasuri prej 863,492.00 €. Bashkëshortja e tij ka deklaruar 520.00 € para të gatshme dhe 5,400.00 € të hyra vjetore, mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione,
- 28. Fatmir Rexhepi** ka deklaruar pasuri prej 2,284,307.00 €. Bashkëshortja e tij ka deklaruar pasuri të luajtshme prej 21,000.00 € dhe të hyra vjetore prej 5,800.00 €, mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme apo aksione.
- 29. Fatmir Xhelili** ka deklaruar pasuri 695,247.00 €. Bashkëshortja e tij ka pasuri të paluajtshme prej 38,000.00€, 24,749.00€ para të gatshme dhe 28,990.00€ të hyra vjetore, ndonëse nuk ka deklaruar pasuri të luajtshme apo aksione.
- 30. Faton Bislimi** ka deklaruar pasuri prej 425,132.00€, ndërsa bashkëshortja e tij ka pasuri të paluajtshme në vlerë prej 35,000.00€ dhe 750.00€ para të gatshme, ndonëse nuk ka deklaruar pasuri të luajtshme apo aksione.
- 31. Ferat Shala** ka deklaruar pasuri totale prej 450,715.00€. Bashkëshortja e tij ka pasuri të luajtshme me vlerë prej 10,000.00€, para të gatshme prej 26,500.00€ dhe të hyra vjetore prej 14,000.00€.
- 32. Fetah Rudi** ka deklaruar pasuri 52,240.00€. Bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione, mirëpo ka të hyra vjetore prej 2,100.00€
- 33. Fidan Rekalii** ka deklaruar pasuri prej 171,151.80€ mirëpo bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.

- 34. Fikrim Damka** ka deklaruar pasuri prej 216,648.00€. Bashkëshortja e tij ka deklaruar pasuri të paluajtshme prej 35,000.00€ mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të luajtshme apo aksione dhe nuk ka të hyrja vjetore apo para të gatshme.
- 35. Fitim Haziri** ka deklaruar pasuri prej 648,290.00€. Bashkëshortja e tij ka deklaruar pasuri të luajtshme prej 3,500.00€, ka para të gatshme prej 1,200.00€ dhe të hyra vjetore prej 2,400.00, mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme apo aksione.
- 36. Frashër Demaj** ka deklaruar pasuri prej 580,908.39€. Bashkëshortja e tij ka deklaruar pasuri të paluajtshme prej 65,000.00€, pasuri të luajtshme prej 7,000.00€, para të gatshme prej 3,378.00€ si dhe të hyra vjetore prej 27,396.00€
- 37. Gazmend Abrashi** ka deklaruar pasuri 11,211,849.99€ mirëpo bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 38. Gazmend Gjyshnica** ka deklaruar pasuri prej 259,000.00€ mirëpo bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 39. Gazmend Sylja** ka deklaruar pasuri prej 126,709.14€ mirëpo bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 40. Gazmend Bytyqi** ka deklaruar pasuri prej 156,609.12€ mirëpo bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione, ndonëse të hyrat vjetore të saj janë 5,400.00€
- 41. Hajredin Kuqi** ka deklaruar pasuri prej 350,214.00€. Bashkëshortja e tij ka pasuri të luajtshme prej 3,000€, para të gatshme në vlerë të 19,000 € dhe të hyra vjetore prej 8,400€.
- 42. Hajrulla Çeku** ka deklaruar pasuri prej 221,989.39€. Bashkëshortja e tij ka pasuri të paluajtshme në vlerë prej 190,000.00€, pasuri të luajtshme prej 12,000.00€, aksione në vlerë prej 1,000.00€ para të gatshme prej 1,168.00€ si dhe të hyra vjetore me vlerë 3,600.00€.
- 43. Hatim Baxhaku** ka pasuri totale prej 395,938.00€ mirëpo bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 44. Haxhi Avdyli** ka deklaruar pasuri prej 514,210.00€. Bashkëshortja e tij ka pasuri të luajtshme prej 17,000.00€, para të gatshme prej 7,010.00€ dhe të hyra vjetore prej 9,600.00€ ndonëse nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme apo aksione.
- 45. Haxhi Shala** ka deklaruar pasuri prej 167,274.00€. Bashkëshortja e tij ka deklaruar para të gatshme prej 3,600.00€ por nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 46. Hekuran Murati** ka deklaruar pasuri prej 124,177.00€ mirëpo bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 47. Igor Simic** ka deklaruar pasuri prej 200,760.96€. Bashkëshortja e tij ka deklaruar 15,000.00 Dinar si para të gatshme dhe të hyra vjetore prej 7,000.00€ ndonëse nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 48. Ilir Ferati** ka deklaruar një pasuri totale prej 383,520.00€ mirëpo bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 49. Ilir Tasholli** ka deklaruar pasuri prej 234,600.00€ mirëpo bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 50. Ismet Beqiri** ka deklaruar pasuri prej 264,019.72€. Të hyrat vjetore të bashkëshortes së tij janë me vlerë 6,000.00€ ndonëse nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
- 51. Ivan Todosijevic** ka deklaruar pasuri prej 223,740.00€. Bashkëshortja e tij ka pasuri të luajtshme me vlerë prej 10,000.00€ dhe të hyra vjetore prej 8,400.00€ mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme apo aksione.

- 52. Jahja Kokaj** ka deklaruar pasuri prej 1,397,488.16€. Bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione, mirëpo ka para të gatshme 30,000.00€
- 53. Kadri Veseli** ka deklaruar pasuri prej 271,311.34€. Bashkëshortja e tij ka pasuri të paluajtshme prej 182,550.00€, para të gatshme 8,360.00€ dhe të hyra vjetore prej 20,874.00€ mirëpo nuk ka deklaruar pasuri të luajtshme apo aksione.
- 54. Kujtim Gashi** ka deklaruar pasuri prej 464,785.00€. Bashkëshortja e tij nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme apo të luajtshme, mirëpo ka para të gatshme të deklaruara me vlerë 4,000.00€ dhe të hyra vjetore 5,400.00€
- 55. Kujtim Shala** ka deklaruar pasuri totale prej 450,980.00€. Bashkëshortja e tij ka para të gatshme 650.00€ dhe të hyra vjetore prej 5,580.00€ por nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme, të luajtshme apo aksione.
